# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-437575**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Nga Ahmetaj, Veliaj, Balluku dhe Meta, Rama flet për përplasjet me drejtësinë: Për këtë të fundit ndjej keqardhje |
| ADRESA | `https://kohajone.com/lajme/nga-ahmetaj-veliaj-balluku-dhe-meta-rama-flet-per-perplasjet-me-drejtesine-per-kete-te-fundit-ndjej-keqardhje/` |
| BURIMI | kohajone.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 19:58:17 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 19:55:44 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `75fdb895e97f37507620160b48a5631cdbde82a8099971313dff13774ccea588` |
| TEKSTI | `e839fff38d4bebc360d9255c150f1e073737185a5eb71459b2a5de49f1785b64` |
| PAMJA | `38f6bfe9371704f92a6811097987e3da0b8bdd2943eaa04e5a4d93d7a257da64` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `52e135049fc4ae8e4e292bcc1ec2e0e569089fced17bd0298a84af5b3e058ede` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `31f34dd8b5054bce377d5d464bdfac48435b1a3c1e78c0f9bdce1a389d75132b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/52e135049fc4ae8e4e292bcc1ec2e0e569089fced17bd0298a84af5b3e058ede`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Nga Ahmetaj, Veliaj, Balluku dhe Meta, Rama flet për përplasjet me drejtësinë: Për këtë të fundit ndjej keqardhje

LAJME E PREMTE, 11 SHTATOR 2026 21:55




Kryeministri Edi Rama, në një intervistë për "Flasim Shqip", foli për proceset gjyqësore ndaj zyrtarëve dhe ministrave të kabinetit të tij, duke u ndalur te rastet e Arben Ahmetajt, Belinda Ballukut, Erion Veliajt dhe Ilir Metës. I pyetur për vendimin për të emëruar Arben Ahmetajn zëvendëskryeministër edhe kur ndaj tij kishte akuza për çështjen e inceneratorëve, Rama tha se akuzat nuk i përdor si kriter për të larguar apo emëruar dikë. '***'Unë duhet të shkarkoja veten time çdo mëngjes ose çdo darkë, sepse ja, jam akuzuar unë. Kjo, duke e ditur shumë mirë veten, më ka bërë gjithmonë të besoj, të dua të besoj që edhe të tjerët akuzohen padrejtësisht",-***tha Rama.

Kryeministri pranoi se në rastin e Ahmetajt koha tregoi se besimi i tij kishte qenë i gabuar. ***"Koha tregoi që në këtë rast kishte investuar në një maskë karnavalesh, jo në një aset publik për t'u besuar. Në qoftë se pastaj del që burimi njerëzor mbi të cilin ti ke investuar është i ndotur, apo njeriu që ti ke parë ka qenë një maskë karnavalesh, atëherë është e dhimbshme, po është fakt".***




Duke folur për çështjen e Belinda Ballukut, kreu i qeverisë kundërshtoi pezullimin e saj nga detyra, duke e konsideruar këtë një ndërhyrje në kompetencat e ekzekutivit dhe të institucioneve të tjera kushtetuese. '***'Prokurori bashkë me një gjykatës u bashkuan bashkë në një dhomë dhe vendosën që të bëjnë kryeministrin, të bëjnë parlamentin, të bëjnë presidentin. Unë këtë s'mund ta pranoj",-***tha Rama.

Ai theksoi se drejtësia duhet të jetë e pavarur, por sipas tij kjo pavarësi nuk nënkupton të drejtën për të marrë vendime që u takojnë institucioneve politike. ***"Ata janë një pushtet i pavarur dhe ne jemi pushteti i pavarur. Ne nuk jemi të***

## LAJMET KRYESORE


"S'kam folur me Trump për projektin", Rama për Sazanin: Ishulli nuk shitet, në Zvërnec ndërtohet një spital i nive...


Rama kritikon Gjykatën Administrative: Për rrogat e veta hapin dyert e thesarit, por jo për hallet e qytetarëve


Berisha në Amerikë, takim me kongresmenin Joe Wilson: Në fokus droga, zgjedhjet dhe qeveria teknike


Ministri Malaj u përgjigjet gjyqtarëve: U shkon paga 567 mijë lekë, 165 milionë euro ikin nga buxheti


"Eja Besfort në Kryeministri!"

## TË PËRZGJEDHURA

1. 
Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!

2. 
Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve

3. 
Dëshirat e Spallettit dhe blerjet e Juventus-it

4. 
Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca

5. 
Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONE-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

## MË TË LEXUARAT

***pavarur nga ligji, por duhet te zbatojme ligjin. Ata jane atje te pavarur nga ne qe te kontrollojne zbatueshmerine e ligjit në raport me interesin publik. Po ata nuk janë të pavarur në pikën që të vendosin për ne".***

Ndërsa për Erion Veliajn, Rama tha se personalisht nuk ka qenë dakord me situatën e krijuar, por nuk kishte as mundësi dhe as arsye për të ndërhyrë në vendimmarrjen e drejtësisë. ***"Në rastin e Kryetarit të Bashkisë, unë nuk kam qenë dakord personalisht, por nuk kam pasur dhe s'kam asnjë mundësi dhe arsye që të them jo, kjo nuk mund të ndodhë. Çfarë vije po shkelin? Ata kanë të drejtë ta bëjnë këtë gjë".*** Kryeministri tha se në çdo vendim mendon jo vetëm për situatën konkrete, por edhe për precedentin që mund të krijohet në të ardhmen. Ai përsëriti se nuk ka komentuar në themel asnjë prej çështjeve gjyqësore ndaj zyrtarëve.

I pyetur nëse në rastin e Ilir Metës mund të ketë hakmarrje politike, Rama e mohoi dhe tha se për ish-presidentin ndien më shumë keqardhje sesa armiqësi. ***"Unë nuk jam njeri hakmarrës. Dhe tjetra, unë nuk kam arsye të hakmerrem me Ilir Metën. Unë për Ilir Metën ndjej keqardhje realisht, se ishte një talent i madh politik që nuk e mbajti dot peshën".***

Rama u shpreh gjithashtu kundër përdorimit të zgjatur të paraburgimit, duke thënë se Shqipëria ka një problem serioz me këtë praktikë. Sa i përket Reformës në Drejtësi, kryeministri tha se përgjegjësia e tij politike është që reforma të vijojë dhe institucionet e reja të konsolidohen. Sipas tij, standardi duhet të jetë i njëjtë për të gjithë, pavarësisht përkatësisë politike. ***"Zotimi para shqiptarëve që këtu s'ka majtas-djathtas, po u identifikove si subjekt hetimi do hetohesh dhe po u identifikove si subjekt dënimi do dënohesh, të mos thyhet si zotim. Nëse unë kam bërë këtë, përgjegjësia ime politike është e kryer".***


**ETIKETA** BALLUKU META RAMA VELIAJ

## MË SHUMË NGA LAJME



**Protestuesit ndalojnë para godinës së Kuvendit: 140 deputetë, të gjit...**



**21 vatra në mbarë vendin, bilanci i orëve të fundit. Ka zjarre në Dib...**



**E sheh veten si President? Rama: Nuk e zgjedh pasardhësin e PS-së, do...**



**Fatmir Mediu poston videon nga Amerika për 25-vjetorin e 11 Shtatori...**



**Pengohet autokolona me makina shqiptare, protestuesit marshojnë drejt...**




**"Pensioni 200 mijë lekë, i sëmurë dhe pa shpresë", protestuesi: Çfarë...**

## LAJMET E FUNDIT



**Nga Ahmetaj, Veliaj, Balluku dhe Meta, Rama flet për përplasjet me drejtësinë: Për këtë të fundit ndjej keqardhje**

12 SEKONDA MË PARË



**Mazonakis humbi jetën, dy mjekë nën hetim. Kërkuan ndihmë nga ChatGPT: Si ta rikthejmë?**

12 MINUTA MË PARË



**Protestuesit ndalojnë para godinës së Kuvendit: 140 deputetë, të gjithë analfabetë**

28 MINUTA MË PARË













**21 vatra në mbarë vendin, bilanci i orëve të fundit. Ka zjarre në Dibër, Shkodër dhe Fier**
35 MINUTA MË PARË

**E sheh veten si President? Rama: Nuk e zgjedh pasardhësin e PS-së, do të jem pjesë e organizatës së Surrelit**
36 MINUTA MË PARË

**Fatmir Mediu poston videon nga Amerika për 25-vjetorin e 11 Shtatorit: Një ditë kujtese dhe reflektimi**
49 MINUTA MË PARË

**MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >**


KOHA JONË

Gazeta **"KOHA JONË"** themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991
Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA



TË FUNDIT
LAJME
SPORTI
EKONOMI
EDITORIAL
WEBTV
AKTUALITET
RAJONI
KOSOVA
BOTA
TEKNOLOGJI
SHOWBIZ
SHËNDETI
SOCIALE
TURIZËM
KURIOZITETE
KULTURA
HISTORIKU
KONTAKT



**BOTUES & DREJTOR:** Nikoll LESI
**KRYEREDAKTOR:** Daniel MUÇAKU
**ZV/KRYEREDAKTOR:** Redjon SHTYLLA
**BORDI:** Elsa KAMBERI, KRYETARE
**NIPT: J71425013C**

**NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA**
SD



© 2024 KOHA JONE. All rights reserved.

PRIVACY POLICY


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.